



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Thirrje publike

për

Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025

Masa 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale

UDHËZIMET PËR APLIKANTËT

Data e hapjes së thirrjes: 27.03.2025.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 18.03.2025.

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	4
Qëllimi i Udhëzuesit.....	4
Përshkrimi i mundësive të aplikimit (projekti).....	5
Objektivat e aplikimit	5
REZULTATET SPECIFIKE	6
Rezultatet e pritshme afatshkurtra:	6
Rezultatet e pritshme afatgjata:.....	7
KUSH MUND TË APLIKOJ?.....	7
Grupi i synuar.....	7
Kriteret e kualifikimit dhe kërkesat specifike	7
Shembuj të mundshëm të projekt propozimit.....	7
Kriteret administrative për aplikim	8
Kriteret për përzgjedhjen e projektit:.....	8
SI TË APLIKONI?	9
Hapat e aplikimit	9
Shpjegimi i procedurës.....	10
Formulari i projekt propozimit.....	10
VLERAT E PLANIFIKUARA TË MBËSHTETJES FINANCIARE	11
Vlera e projekteve për të cilat mund të aplikojnë komunat.....	11
Vlera e projekteve	11
DOKUMENTET DHE INFORMACIONET E KËRKUARA	12
Lista e dokumenteve që duhet të dorëzohen	12
Dokumentet shtesë:	13
Udhëzime për mënyrën e dorëzimit	13
AFAFTET E APLIKIMIT	13
Data e hapjes dhe mbylljes së aplikimit.....	13
PROCESI I VLERËSIMIT DHE SELEKTIMIT.....	13
Kualifikueshmëria e projekteve	14
Aplikacionet e suksesshme dhe të pasuksesshme.....	14
Kushtet e pranueshmërisë	14
Kostot e pranueshme	14
Kostot e papranueshme.....	14
Kostot e pranueshme	15
Kostot e papranueshme.....	15
ROLI I QENDRAVE PËR ZHVILLIM RAJONAL (QZHR)	15
PROCEDURAT E IMPLEMENTIMIT	15

PROCEDURAT E PROKURIMIT.....	15
MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	16
PAGESAT E VAZHDUESHME PËR OE TË KONTRAKTUAR	16

Shkurtesat

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
DPKZHR	Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
DBF	Divizioni për Buxhet dhe Financa
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
PIP	Programi i Investimeve Publike
AZHR	Agjencitë për Zhvillimit Rajonal

HYRJE

Qëllimi i Udhëzuesit

Kjo thirrje ka për qëllim të ofrojë informacion të detajuar dhe udhëzime të qarta për aplikim në **Masën 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale (2025)**. Ajo synon të ndihmojë komunat dhe akterët e tjerë të interesuar të përgatisin dhe paraqesin projekt propozime që do të kontribuojnë në zhvillimin e balancuar dhe të qëndrueshëm të rajoneve të Kosovës.

Thirrja ka për qëllim përmirësimin e kushteve ekonomike, sociale dhe mjedisore përmes investimeve direkte në nivel lokal, si dhe mbështetjen e aktiviteteve zhvillimore që rrisin kohezionin rajonal dhe zvogëlojnë pabarazitë.

Masa 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale, përshin:

- **Nën Masa 1.1: Investime në infrastrukturë publike komunale**

Kjo masë fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës komunale, përfshirë investime në rrugë, ura, furnizim me ujë dhe kanalizime, si dhe ndërtimin dhe rinovimin e objekteve publike. Qëllimi i kësaj nën mase është përmirësimi i kushteve të jetesës dhe rritja e mundësive për zhvillim ekonomik në nivel lokal.

- **Nën Masa 1.2: Investime në infrastrukturë dhe dixhitalizim**

Kjo masë synon përmirësimin e infrastrukturës dhe avancimin e procesit të dixhitalizimit, duke mundësuar lidhje më të shpejta interneti dhe shërbime dixhitale, si dhe modernizimin e administratës lokale, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe nxitjen e inovacionit.

- **Nën Masa 1.3: Projekte për zhvillim të qëndrueshëm, turizëm dhe trashëgimi kulturore**

Kjo masë ka për qëllim zhvillimin e turizmit dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, përmes investimeve në infrastrukturën turistike dhe restaurimin e monumenteve historike. Ajo synon të nxjerrë në pah mundësitë për zhvillim ekonomik dhe të krijojë mundësi punësimi për komunitetet lokale.

Të tri nën masat bashkë kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar të rajoneve të Kosovës, duke synuar të rrisin kontributin e secilit rajon në performancën kombëtare dhe të krijojnë një shoqëri më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Përshkrimi i mundësive të aplikimit (projekti)

Në kuadër të **Masës 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale (2025)**, mundësitë e aplikimit janë të hapura për komunat e Kosovës për të paraqitur projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe zhvillimin e infrastrukturës rajonale.

Projekti duhet të kontribuoj në përmirësimin e produktivitetit, standardeve sociale dhe mjedisore, si dhe në forcimin e kohezionit rajonal. Aplikantët do të kenë mundësinë të sigurojnë mbështetje financiare për realizimin e aktiviteteve zhvillimore që përputhen me objektivat e Strategjisë për Zhvillim Rajonal të Kosovës dhe me nevojat specifike të rajonit përkatës.

Për vitin 2025, buxheti i parashikuar për këtë program është rreth 4,000,000 euro. Nga ky buxhet, Ministria ka kontraktuar në vitin 2024 disa projekte dy-vjeçare në komuna të ndryshme, me një vlerë totale prej 1,769,160 euro për vitin 2025. Diferenca midis buxhetit të aprovuar dhe vlerës së kontraktuar për projektet dy-vjeçare paraqet shumën e mbetur për projekt propozimet e reja.

Ministria për Zhvillim Rajonal do të angazhohet për rritjen e buxhetit për këtë Masë dhe do të kërkojë miratimin e një buxheti të rritur nga Qeveria e Republikës së Kosovës për vitin 2025.

Objektivat e aplikimit

Thirrja fokusohet në tri objektiva kryesore:

- I. **Mbështetje për projekte gjithëpërfshirëse.** Ky program synon të mbështesë projekte që ndjekin një qasje të integruar, në përputhje me objektivat e Strategjisë për Zhvillim Rajonal dhe strategjitë lokale përkatëse. Kjo do të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar për çdo rajon të Kosovës, duke përfshirë të gjitha aspektet socio-ekonomike dhe ekologjike.
- II. **Rritja e potencialeve ekonomike, turistike dhe mjedisore.** Programi ka për qëllim rritjen e potencialit ekonomik dhe turistik të rajoneve, duke përmirësuar gjithashtu menaxhimin mjedisor. Projektet do të ndërthurin aspekte të turizmit, ekonomisë, kulturës dhe mjedisit, duke u fokusuar në përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe krijimin e mundësive zhvillimore për rajonet e ndryshme.
- III. **Përkrahja e komunave për zhvillimin e projekteve inovative.** Ky objektiv synon të mbështesë komunat në identifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e projekteve që

pasqyrojnë karakteristikat dhe potencialet unike të çdo rajoni. Kjo përfshin zhvillimin e turizmit natyror, kulturor dhe sportiv, duke siguruar ndërhyrje konkrete në zonat urbane dhe rurale për përmirësimin e kushteve të jetesës.

REZULTATET SPECIFIKE

Krijimi i këtij programi do të mundësojë përmirësimin e zhvillimit socio-ekonomik të komunave përmes projekteve që kontribuojnë në arritjen e prioritetëve të përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit Rajonal dhe atij Lokal. Rezultatet e pritshme ndahen në dy periudha kohore:

Rezultatet e pritshme afatshkurtra:

1. **Fuqizimi i kapaciteteve komunale:** Komunitat do të zhvillojnë dhe forcojnë kapacitetet e tyre për të identifikuar, zhvilluar, zbatuar, monitoruar dhe mirëmbajtur projekte kapitale.
2. **Projekte të zhvilluara me komunitetin dhe palët e interesit:** Projekte të identifikuara dhe zhvilluara në bashkëpunim me komunitetin dhe palët relevante të interesit, përfshirë organizatat joqeveritare dhe akterë të tjerë.
3. **Projekte të bazuara në karakteristikat dhe potencialet vendore:** Projekte që reflektojnë karakteristikat dhe potencialet e veçanta të rajonit, ndërkohë që kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin socio-ekonomik të zonave të caktuara.
4. **Rritja e kohezionit social dhe mbrojtja e aseteve natyrore e kulturore:** Projekte që kontribuojnë në forcimin e kohezionit social, duke promovuar dhe mbrojtur asetet natyrore dhe kulturore të rajoneve.
5. **Projekte të bashkëfinancuara nga dy ose më shumë komuna:** Projektet që zhvillohen përmes bashkëfinancimit nga dy ose më shumë komuna, të cilat inkurajohen dhe preferohen për të rritur efektivitetin dhe bashkëpunimin ndër-komunal.
6. **Pronësia e projekteve nga autoritetet publike dhe palët e interesit:** Rritja e pronësisë mbi projektet nga autoritetet publike, shoqëria civile, komuniteti dhe palët e interesit të tjera, duke siguruar mbështetje dhe angazhim afatgjatë.
7. **Gatishmëria politike dhe teknike:** Angazhimi i autoriteteve lokale përmes planifikimeve buxhetore të përshtatshme dhe proceseve të hapura dhe transparente, duke siguruar gatishmëri politike dhe teknike për zbatimin e projekteve.

Rezultatet e pritshme afatgjata:

1. **Institucione lokale të përgatitura për menaxhimin e projekteve:** Autoritetet publike lokale do të jenë të përgatitura për menaxhimin e suksesshëm të ciklit të plotë të projekteve të investimeve kapitale.
2. **Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe zbatimit të projekteve:** Rritja e transparencës dhe gjithëpërfshirjes gjatë fazave të identifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të projekteve, duke mundësuar një qasje më efikase dhe të drejtë.
3. **Përmirësimi i cilësisë së jetës për qytetarët:** Përmirësim i kushteve të jetesës për qytetarët në zonat dhe rajonet e caktuara, duke siguruar mundësi më të mira për zhvillimin e komunitetit.
4. **Reduktimi i pabarazive ndërmjet rajoneve:** Rritja e barazisë në zhvillimin socio-ekonomik ndërmjet rajoneve të ndryshme të Kosovës, duke adresuar pabarazitë ekzistuese dhe krijuar mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët.

KUSH MUND TË APLIKOJ?

Grupi i synuar

Grupi i synuar në këtë thirrje përfshin të gjitha komunat e Kosovës. Aplikantët e tjerë potencialë, si Këshillat e Komunitetit, OJQ-të dhe Asociacionet, duhet të drejtojnë kërkesat e tyre përmes komunave përkatëse, të cilat përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim.

Kriteret e kualifikimit dhe kërkesat specifike

Shembuj të mundshëm të projekt propozimit

- **Projekte natyrore:**
 - o Krijimi i parqeve natyrore
 - o Shtigje për ecje dhe alpinizëm
 - o Ballkone panoramike
 - o Ura panoramike (*druri, guri, etj.*)
 - o Zhvillimi i turizmit natyror
- **Projekte kulturore:**
 - o Rehabilitimi i lagjeve të caktuara dhe rindërtimi i qendrave historike të qytetit
 - o Qendra të informacionit që ofrojnë mundësi për eksplorimin e turizmit malor, aktiviteteve kulturore dhe sportive.

- **Projekte sportive:**
 - o Krijimi i fushave dhe objekteve sportive
 - o Ndërtimi i platformave për paragliding dhe hedhje me parashuta
 - o Ndërtimi i platformave për zbritje me tela (zip-lining) nëpër kanione ose lugina
 - o Ndërtimi i platformave për Pump Track Skateboarding
- **Projekte shëndetësore:**
 - o Ndërtimi i qendrave rehabilituese për individë me varësi
 - o Ndërtimi i qendrave me karakter shëndetësor
- **Infrastrukturë përcjellëse:**
 - o Krijimi i shtigjeve dhe rrugëve për ecje si dhe ndriçimi
 - o Krijimi/renovimi i stacioneve dhe vend pritjeve për sigurimin e qasjes dhe mundësive për aktivitete të ndryshme

Kriteret administrative për aplikim

Komunat aplikues duhet të zhvillojnë idenë e projektit në formë të projekt propozimit, i cili përmban:

- **Pjesën narrative**
E cila duhet të plotësohet sipas formës aplikuese (*Shtojca 1*).
- **Pjesën grafike**
Në formën e një dizajni paraprak të projektit të propozuar, që mund të jetë në formë skice ose vizatimi. Ky dizajn duhet të shpjegojë qartë idenë e projektit për vlerësimin nga MZHR-ja.
- **Pjesën e kostos**
Kostoja e përafërt për aktivitetet dhe komponentët kryesorë të projektit.

Kriteret për përzgjedhjen e projektit:

1. **Pajtueshmëria me objektivin e Programit:** Projekti duhet të jetë në përputhje me objektivin e përgjithshëm të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025 dhe, kur të jetë e mundur, të përputhet edhe me Strategjitë e Zhvillimit Rajonal dhe Lokal.
2. **Ndikimi në mjedis dhe shëndet:** Projekti duhet të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit natyror dhe/ose të lehtësojë rreziqet nga fatkeqësitë natyrore. Për projektet me ndikim të theksuar ekonomik, Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) do të aplikohet sipas legjislacionit në fuqi.
3. **Procesi i identifikimit dhe përzgjedhjes:** Komuna duhet të sigurojë që projekti është identifikuar përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës, duke përdorur

- metodologji si takime publike, punëtori, pyetësorë, etj. Dëshmitë mbi këtë proces (raporte, foto, lista të pjesëmarrësve) duhet të bashkëngjiten aplikacionit.
4. **Projekte të reja:** Projektet duhet të jenë të reja dhe jo vazhdimësi e projekteve të tjera, përveç në rastet kur projekti është bartur nga viti i kaluar dhe ka arsye të mjaftueshme për vazhdim.
 5. **Plani i menaxhimit:** Projekti duhet të përmbajë një plan menaxhimi realist dhe të implementueshëm, për të siguruar suksesin e tij gjatë zbatimit.
 6. **Inkurajimi i projekteve të përbashkëta:** Inkurajohen aplikimet për projekte të përbashkëta, që përfshijnë dy apo më shumë komuna.
 7. **Bashkëfinancimi:** Komunitat obligohen të ofrojnë bashkëfinancim deri në 49% të vlerës së projektit.
 8. **Gjetja e Donatorëve:** MZHR inkurajon komunitat të gjejnë donatorë për bashkëfinancimin e projekteve, sidomos në rastet kur shumat e projekteve tejkalojnë mundësitë buxhetore të MZHR-së dhe komunës. Donatorët mund të përdoren edhe për mbulimin e shumës së bashkëfinancimit të projektit.
 9. **Realizueshmëria dhe afati i përfundimit:**
 - Projekti duhet të përfundojë brenda vitit fiskal 2025 (*përfundim mund të bëhet për projektet që kanë financim dhe implementim më të gjatë se një vit, të cilat do të trajtohen me Memorandum Mirëkuptimi*).
 - Projekti duhet të realizohet në pronë të komunës ose pronë publike, ku komuna ka të drejtë formale për realizimin e projektit dhe pronësinë mbi asetet dhe të drejtat. Dëshmitë për këtë duhet të bashkëngjiten aplikacionit.

SI TË APLIKONI?

Për të aplikuar për financim, mund të merrni udhëzimet dhe format për aplikim në kopje fizike nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), ose mund t'i shkarkoni direkt nga ueb faqja zyrtare e MZHR-së.

Hapat e aplikimit

1. **Kompletimi i dokumenteve të kërkuara.**

Sigurohuni që të përgatiten dhe të plotësohen të gjitha dokumentet dhe informacionet që kërkohen sipas udhëzimeve të thirrjes për aplikim.
2. **Përgatitja e projekt propozimit**

Përgatitni një projekt propozim, që përfshin objektivat, aktivitetet, buxhetin dhe planin e zbatimit.

3. Formularët dhe materialet përcjellëse

Formularët dhe materialet e nevojshme mund të merren në ueb faqen e MZHR-së në këtë link: <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,36>

4. Dorëzimi i aplikimit

Dokumentet e aplikimit duhet të dorëzohen në kopje fizike, të nënshkruar nga kryetari i komunës, si dhe në USB. Formulari i aplikimit i ngarkuar në USB duhet të jetë në programin Word.

Projekt propozimet së bashku me dokumentacionin përcjellës duhet të dorëzohen në arkivin e MZHR-së.

Shpjegimi i procedurës

Formulari i projekt propozimit

Formulari i projekt propozimit duhet të përmbajë informacion të plotë dhe të saktë mbi përmbajtjen e projektit. Është e domosdoshme që të gjitha fushat të plotësohen plotësisht.

Për të siguruar një aplikim të plotë dhe të qartë, pyetjet në formularin e aplikimit duhet të plotësohen sa më saktë dhe në mënyrë të detajuar. Të gjitha pyetjet janë të rëndësishme, por vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet:

- Qëllimi i përgjithshëm dhe objektivat e projektit (*minimum 300 fjalë*)
- Nevoja dhe arsyeja për realizimin e projektit
- Rezultatet e drejtpërdrejta të projektit
- Përfundimi i projektit brenda afatit kohor të parashikuar
- Qëndrueshmëria e projektit pas përfundimit
- Aspekti mjedisor i projektit

Rajonet zhvillimore dhe Komunat

Rajoni Zhvillimor		Komunat
(01)	Qendër	Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Lipjan, Glllogoc, Graçanicë
(02)	Veri	Mitrovica e Jugut, Skenderaj, Vushtri, Zveqan, Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovica Veriore
(03)	Perëndim	Pejë, Istog, Klinë, Deçan
(04)	Jug	Prizren, Suharekë, Dragash, Mamushë
(05)	Juglindje	Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpçë, Hani i Elezit
(06)	Lindje	Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërda, Partesh, Ranillukë, Killokot
(07)	Jugperëndim	Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Junik

VLERAT E PLANIFIKUARA TË MBËSHTETJES FINANCIARE

Projektet me të cilat aplikojnë komunitat, do të klasifikohen si investime kapitale, të cilat janë në përputhje me objektivat kryesore të thirrjes, duke kontribuar në zhvillimin socio-ekonomik rajonal.

Vlera e projekteve për të cilat mund të aplikojnë komunitat

Shuma totale e mundshme që ofrohet përmes kësaj Thirrjeje për Aplikime është rreth **1.9 milion euro**. Autoriteti Kontraktues ka të drejtën të vendosë të mos ndajë të gjitha fondet e disponueshme.

Vlera e projekteve

- **Kategoria e parë:** Kjo kategori është e dedikuar për projekte të infrastrukturës publike që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik rajonal dhe ato që lidhen me zonat ekonomike, sipas kërkesave të komunave, në kuadër të thirrjes për propozime të shpallur nga Ministria për Zhvillim Rajonal (MZHR).

Nëse në kuadër të kësaj thirrjeje aplikon vetëm një komunë si e vetme, vlera e kërkuar për projekt nga MZHR duhet të jetë brenda vlerave të mëposhtme (*minimale dhe maksimale*):

Shuma minimale e projektit	Shuma maksimale e projektit
100,000.00 €	400,000.00 €

- ❖ Varësisht nga projekti vlerat e mësipërme mund të ndahen deri në dy vite.
- ❖ Në raste kur një projekt propozimi plotëson kriteret dhe është në përputhje me mandatet e MZHR-së, ai mund të tejkalojë vlerat e përcaktuara më lartë. Financimi dhe zbatimi i projektit do të kërkojë një periudhë më të gjatë se një vit.
- **Kategoria e dytë:** Kjo kategori është e dedikuar për projekte të infrastrukturës publike që mbështesin zhvillimin socio-ekonomik rajonal. Projektet që lidhen me zonat ekonomike, sipas kërkesave të komunave në kuadër të thirrjes për propozime të lansuar nga Ministria për Zhvillim Rajonal (MZHR).
Në rast se aplikojnë dy ose më shumë komuna, vlera e kërkuar për projekt nga MZHR duhet të jetë brenda kufijve të mëposhtëm (*minimale dhe maksimale*):

Shuma minimale e projektit	Shuma maksimale e projektit
200,000.00 €	500,000.00 €

- ❖ Varësisht nga projekti vlerat e mësipërme mund të ndahen deri në tri vite.
- ❖ Në raste kur një projekt propozimi plotëson kriteret dhe është në përputhje me mandatet e MZHR-së, ai mund të tejkalojë vlerat e përcaktuara më lartë. Financimi dhe zbatimi i projektit do të kërkojë një periudhë më të gjatë se një vit.

- **Kategoria e tretë:** Kjo kategori është e dedikuar për kërkesat individuale të komunave që vijnë gjatë vitit 2025, edhe pas mbylljes së Thirrjes. Kërkesat mund të vijnë si rezultat i vizitave apo aktiviteteve tjera nëpër komuna. Kërkesat individuale të komunave mund të dorëzohen deri më **29 gusht 2025**.

Kufijtë e shumave për projektet në këtë kategori janë si vijon:

Shuma minimale e projektit	Shuma maksimale e projektit
50,000.00 €	100,000.00 €

- ❖ Projektet e përzgjedhura nga kjo kategori në rast të mosrealizimit gjatë vitit aktual fiskal mund të planifikohen për vitin vijues fiskal.

DOKUMENTET DHE INFORMACIONET E KËRKUARA

Lista e dokumenteve që duhet të dorëzohen

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban formën e aplikimit dhe anekset e detyrueshme, siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

1. **Formulari i aplikimit** (Shtojca 1)
2. **Pjesa grafike** - dizajni paraprak i projektit të propozuar, në formë skice të detajuar.
3. **Pjesën e koston** - kostoja e përafërt e projektit
4. **Dëshmi të konsultimeve me publikun** gjatë identifikimit dhe zhvillimit të projektit, si: lista të pjesëmarrësve, foto nga takimet, anketim online mbi kërkesat e tyre rreth projektit, etj.
5. **Dokumentacioni pronësor juridik** - kopja e planit dhe fleta poseduese
6. **Pëlqimet e nevojshme nga ministritë përkatëse** (nëse projekti kërkon pëlqime të tilla)
7. **Konfirmimi i komunës për qëndrueshmëri të projektit**

8. Konfirmimi nga Drejtoria e Urbanizmit e komunës aplikuese për planin rregullues/hartën zonale
9. Konfirmimin nga ana e Departamentit/Zyra Ligjor të Komunës Aplikuese se prona e cila është e përfshirë në projekt nuk ka ndonjë kontest gjyqësor

Dokumentet shtesë:

Nëse një komunë ka miratimin ose bashkëpunimin për projektin e saj me ministritë përkatëse, këto të dhëna duhet të bashkëngjiten me kërkesën. Ky bashkëpunim është shpesh i nevojshëm për projekte që lidhen me turizmin, bujqësinë, mjedisin dhe infrastrukturën komunale.

Udhëzime për mënyrën e dorëzimit

Formulari i aplikimit gjendet në *shtojcën (1)* dhe duhet të plotësohet në mënyrë elektronike. Ai duhet të dorëzohet në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR) deri më datë 18 prill 2025.

- Dokumentet e aplikimit duhet të dorëzohen në kopje fizike, nënshkruar nga kryetari i komunës, si dhe në USB. Formulari i aplikimit i ngarkuar në USB duhet të jetë në programin Word. ,
- Në rast se aplikimi është në partneritet me komuna të tjera, duhet të plotësohet gjithashtu Deklarata e Partneritetit, e cila është e përcaktuar në shtojcën (2).

Projekt propozimet së bashku me dokumentacionin përcjellës duhet të dorëzohen në arkivin e MZHR-së.

AFAFTET E APLIKIMIT

Data e hapjes dhe mbylljes së aplikimit

Afati për aplikim fillon me 27.03.2025 dhe deri 18.04.2025 në orën 16:00. Aplikantit do t'i lëshohet një dëshmi se aplikimi është pranuar brenda periudhës së thirrjes.

Përgjatë, bëjnë kërkesat individuale të komunave të cilat mund të dorëzohen deri më 29 gusht 2025.

PROCESI I VLERËSIMIT DHE SELEKTIMIT

MZHR do të formojë një komision vlerësues, i cili do të jetë përgjegjës për vlerësimin e projekt propozimeve. Gjatë këtij procesi, komisioni mund të kërkojë informacione

dhe dokumentacione shtesë nga komunat për projekt propozimet.

Kualifikueshmëria e projekteve

Për të u kualifikuar, projektet duhet të arrijnë një rezultat minimal prej 50% të pikëve. Në rast se projekti miratohet, por nuk pajtohet me Marrëveshjen e Mirëkuptimit, DPKZHR (Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal) do të rekomandojë projektin e radhës për miratim nga lista rezervë.

Aplikacionet e suksesshme dhe të pasuksesshme

- **Aplikimet e suksesshme:** Komunat që kanë projekte që arrijnë të kalojnë kufirin e 50% të pikëve do të përfitojnë Marrëveshjet e Mirëkuptimit (MM), sipas renditjes, deri në realizimin e plotë të buxhetit.
- **Aplikimet e pasuksesshme:** Projektet që nuk arrijnë të kalojnë kufirin e 50% të pikëve nuk do të financohen nga MZHR.

Kushtet e pranueshmërisë

Ky fond është i hapur për aplikime nga të gjitha komunat. Secila komunë mund të aplikojë sipas kategorive të përcaktuara. Aplikimet duhet të përputhen me kriteret e përcaktuara në paketën e aplikimit dhe të jenë brenda kompetencave të komunave, siç përcaktohet në Nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë.

Kostot e pranueshme

Kostot e pranueshme të projektit duhet të përfshijnë ato elemente që janë thelbësore për realizimin e suksesshëm të projektit.

Kostot e papranueshme

Të gjitha shpenzimet që lidhen me zhvillimin dhe menaxhimin e projektit, si dhe ato për burimet njerëzore, nuk do të kompensohen për realizimin e projektit.

KUSHTET E PRANUESHME

Ky fond është i hapur për aplikime për të gjitha komunat e Kosovës. Çdo komunë mund të paraqesë aplikime sipas kategorive të përcaktuara. Aplikimet duhet të përputhen me kriteret e specifikuar në paketën e aplikimit dhe të jenë brenda kufijve

të kompetencave të komunave, siç përcaktohet në Nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës.

Kostot e pranueshme

Kostot që konsiderohen të pranueshme për projektin duhet të përfshijnë vetëm ato shpenzime që janë thelbësore dhe të nevojshme për sigurimin e realizimit të suksesshëm të projektit. Ato duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet e propozuara dhe realizimin e objektivave të projektit.

Kostot e papranueshme

Të gjitha shpenzimet që lidhen me zhvillimin dhe menaxhimin e projektit, përfshirë ato për burimet njerëzore (paga, shpërblime, etj.), nuk do të kompensohen nga fondi për realizimin e projektit.

ROLI I AGJENCIVE PËR ZHVILLIM RAJONAL (AZHR)

Komunat mund të ftojnë Agjencitë për Zhvillimit Rajonal (AZHR) që u përkasin për t'i mbështetur në zhvillimin dhe përgatitjen e projekteve të pranueshme, të cilat bazohen në strategjitë lokale dhe rajonale për zhvillim ekonomik. Përveç kësaj, AZHR-të mund të kontribuojnë gjithashtu në hartimin e projekt propozimeve për komunat.

PROCEDURAT E IMPLEMENTIMIT

Zhvillimi dhe miratimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit (MM): Komunat që dorëzojnë aplikime të suksesshme do të informohen nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) sa më shpejt pas përfundimit të procesit të vlerësimit. MM do të përgatitet nga MZHR-ja dhe do të diskutohen me komunat. Pas arritjes së pajtueshmërisë nga të dyja palët, MM mund të nënshkruhet.

PROCEDURAT E PROKURIMIT

- **Inicimi i procedurave të prokurimit**
Për kontraktimin e Operatorit, MZHR është bartësja e procedurave të prokurimit, përveç nëse ndryshe përcaktohet në marrëveshjen e mirëkuptimit.
- **Angazhimi i MZHR-së në procedurat e prokurimit**
Nëse komunat realizojnë vet procedurat e prokurimit, MZHR merr pjesë me një anëtar në hapjen e ofertave, vlerësimin e ofertave, trajtimin e kërkesave për

rishqyrtim dhe ri-vlerësimin nëse ka një vendim për rishqyrtim. Në rast se MZHR nuk njoftohet me kohë për përfshirje në procesin e prokurimit atëherë përgjegjësia kalon komplet tek komuna dhe MZHR do të evidentoj si rast i cili edhe mund ta penalizoj për financime të ardhmen komunën në fjalë.

- **Respektimi i Ligjit për Prokurimin Publik**

Të gjitha procedurat e prokurimit duhet të zhvillohen në përputhje me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Kosovë (LPP) dhe legjislacioni sekondar në fuqi.

- **Komuna obligohet të njoftoj MZHR-n për lidhjen e Kontratës me OE.**

Komunat obligohen që pas përfundimit të procedurave të prokurimit dhe pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik (OE), të njëjtën ta përcjellin në MZHR-në.

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

- **Monitorimi i projekteve nga MZHR-ja**

MZHR do të monitorojë projektin gjatë gjithë fazave të implementimit dhe mund të angazhojë gjithashtu kompani të jashtme për të monitoruar realizimin e tij.

- **Përgjegjësit e monitorimit?**

DPKZHR do të kordinoj bashkëpunimin mes Menaxherit të projektit ose Organit Mbikëqyrës të caktuar nga Kryetari i Komunës pas nënshkrimit të kontratës.

- **Raportimi nga komunat**

Komunat janë të obliguara të raportojnë mbi progresin e projekteve të MZHR-ja dhe të dorëzojnë një raport final në fund të projektit.

- **Procedurat e pranimi teknik**

Pas dorëzimit të raportit narativ të implementimit të projektit, komunat duhet të fillojnë procedurat për pranimin teknik të projektit.

- **Regjistrimi i pasurisë**

Pas pranimi teknik, komunat duhet të përfundojnë dokumentacionin dhe ta dërgojnë te zyrtari përgjegjës i MZHR-së për regjistrimin e pasurisë. Pasi të regjistrohet pasuria, MZHR-ja do ta transferojë projektin si pasuri të Komunës përfituesen.

PAGESAT E VAZHDUESHME PËR OE TË KONTRAKTUAR

Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë faturën dhe kërkesën për pagesë në MZHR/Komunë. Pas verifikimit të procedurave, pagesa do të bëhet sipas Ligjit për

Menaxhimin e Financave Publike. MZHR dhe Kompania monitoruese do të verifikojnë punët në terren para pagesës.